



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

RREGULLORE (QRK) – NR. 01/2025
PËR MEKANIZMIN KOORDINUES LOKAL PËR MBROJTJE NGA
DHUNA NË FAMILJE, DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA
GJINORE¹

¹ Rregullore (QRK) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, është miratuar në Mbledhjen e 249-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.01/249, të datës 26.02.2025.

Qeveria e Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 25 (paragrafi 5) të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore (GZ, Nr. 22/12.10.2023), në pajtim me nenin 8 (paragrafi 4, nën paragrafi 4.5) të Ligjit Nr. 08/117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) – Nr. 01/2025 PËR MEKANIZMIN KOORDINUES LOKAL PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE, DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE

Neni 1 Qëllimi

1.Qëllimi i Rregullores është përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësiive të Mekanizmit Koordinues Lokal për mbrojtjen dhe ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjimore në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Kjo Rregullore është në përputhshmëri me:

2.1.Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në familje (NR. 2024/1385);

2.2.Direktivën Nr.2012/29/EU e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian për caktimin e standardeve minimale për të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit;

2.3.Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për të gjithë mekanizmat koordinues lokal në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Parimet themelore

1.Mekanizmi Koordinues Lokal koordinon aktivitetet për parandalimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të të gjitha formave të dhunës pa diskriminim në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë bazë tjetër me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

2.Mekanizmi Koordinues Lokal sigurohet në ruajtjen e konfidencialitetit të viktimave dhe mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3.Mekanizmi Koordinues Lokal aplikon qasje me viktimën në qendër gjatë ofrimit të mbështetjes për viktimat e të gjitha formave të dhunës, duke i marrë parasysh të drejtat dhe nevojat e viktimave.

Neni 4

Mekanizmi Koordinues Lokal

1. Mekanizmi Koordinues Lokal ka këtë përbërje:

1.1.Kryetari/ja i/e Komunës – Kryesues/e;

1.2. Drejtori/esha i/e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale apo drejtori përkatës që mbulon fushën e shëndetësisë apo mirëqenies sociale;

1.3.Drejtori/esha i/e Qendrës për Punë Sociale;

1.4.Udhëheqësi/ja i/e Shërbimeve Sociale, Qendra për Punë Sociale;

1.5.Drejtori/esha Komunal/e i/e Arsimit;

1.6. Zyrtari/ja për Barazi Gjinore;

1.7.Drejtori/esha i/e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;

1.8.Përfaqësues nga Zyra për Komunitete dhe Kthim;

1.9. Përfaqësues nga strehimorja;

1.10.Përfaqësues nga OJQ-të në nivelin lokal aktive në të drejtat e njeriut/grave.

2.Në bazë të nenit 9 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, ftohen të jenë pjesë në Mekanizmin Koordinues Lokal:

- 2.1.Mbrojtësi i Viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;
 - 2.2. Përfaqësues nga Gjykata;
 - 2.3. Përfaqësues nga Prokuroria;
 - 2.4. Përfaqësues nga Policia;
 - 2.5. Përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
 - 2.6. Përfaqësues nga Zyrat e Punësimit;
 - 2.7. Përfaqësues nga Qendra e Shëndetit Mendor.
- 3.Në mungesë të Kryesuesit, rolin e Zëvendëskryesuesit të Mekanizmit Koordinues Lokal e ushtron Nënkryetari i parë i Komunës.
- 4.Mekanizmi Koordinues Lokal sipas nevojës mund të ftojë në takim edhe përfaqësues të institucioneve relevante.
- 5.Kryetari i Komunës për mbështetje administrative teknike cakton sekretarinë e Mekanizmit Koordinues Lokal.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e Mekanizmit Koordinues Lokal

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Mekanizmit Koordinues Lokal janë:

- 1.1. të identifikoj nevojat për ofrimin e mbështetjes për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore në pajtim me përkufizimet e dhëna në Konventën e Stambollit dhe ligjin në fuqi;
- 1.2. të koordinoj politikat për ofrimin e shërbimeve specifike të nevojshme për mbështetjen e viktimave të dhunës;
- 1.3.të koordinoj punën e institucioneve përkatëse në nivel lokal për parandalimin, mbrojtjen, ofrimin e mbështetjes si dhe të kontribuoj në eliminimin e të gjitha formave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore;
- 1.4.harton plane të veprimit në nivelin komunal me qëllim të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave;
- 1.5.mbledh, analizon dhe rekomandon politika të veprimit në parandalim të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore;
- 1.6.propozon buxhetin për ofrimin e shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore i cili aprovohet nga Kuvendi i Komunës;

1.7.të rrisë ndërgjegjësimin dhe ndërtojnë kapacitete për zhvillimin e tolerancës zero ndaj dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore;

1.8.të bashkërendojë përpjekjet me Organizatat Jo Qeveritare për të drejtat e grave;

1.9.Mekanizmi Koordinues Lokal trajton me prioritet të gjitha masat dhe aktivitetet për të parandaluar dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën në baza gjinore;

1.10.Mekanizmi Koordinues Lokal përcakton dhe zbaton politikat për ri-integrimin, rehabilitimin, pavarësinë ekonomike dhe financiare të viktimës;

1.11.Mekanizmi Koordinues Lokal përdor qasje të ndërthurur në të gjitha fazat e vlerësimit të gjendjes, zbatimit dhe vlerësimit të politikave.

Neni 6

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Mekanizmit Koordinues Lokal

1.Kryesuesi i Mekanizmit Koordinues Lokal ka këto përgjegjësi:

1.1. fton takime dhe përcakton rendin e ditës;

1.2. në raste specifike, fton një grup të ngushtë profesional për trajtim të rastit, varësisht nivelit të rrezikshmërisë dhe kërkesës së Qendrës për Punë Sociale dhe anëtarëve të tjerë;

1.3.siguron proces të rregullt të komunikimit të brendshëm gjatë mbledhjeve të Mekanizmit Koordinues Lokal;

1.4.koordinon punën e Mekanizmit Koordinues Lokal për hartimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, i cili miratohet nga Kuvendi i Komunës;

1.5.raporton progresin e zbatimit të planeve të veprimit dhe politikave të miratuara për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Mekanizmit Koordinues Lokal

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Mekanizmit Koordinues Lokal janë:

1.1.anëtarët e Mekanizmit Koordinues Lokal duhet të marrin pjesë rregullisht në takime dhe të kontribuojnë në punën e mekanizmit si dhe në takimet e jashtëzakonshme;

1.2.të sigurojnë të dhëna statistikore për Mekanizmin Koordinues Lokal duke evidentuar sfidat specifike me të cilat përballen viktimat në sektorin e tyre të veçantë, si dhe zhvillimet dhe trendet e fundit;

1.3.të kordinojnë veprime për sigurimin e shërbimeve adekuate për viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore;

1.4.të kordinojnë politikat për re-integrimin dhe riatdhësimin e të mbijetuarave të dhunës në familje dhe shërbime të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse;

1.5.të raportojnë mbi veprimet, zhvillimet dhe sfidat specifike për institucionin/punëdhënësinë e tyre përkatës;

1.6. në raste specifike emergjente të kenë koordinim dhe komunikim të drejtpërdrejtë me anëtarët e tjerë të Mekanizmit Koordinues Lokal për t'i mbështetur viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore;

1.7.anëtarët e Mekanizmit Koordinues Lokal janë të detyruar ta respektojnë privatësinë dhe standardet e konfidencialitetit dhe të mos zbulojnë të dhëna personale të viktimave/mbijetuarave, si dhe ta ruajnë si informacion të klasifikuar çdo informacion që e kanë mësuar gjatë ushtrimit të detyrës së tyre që konsiderohet fshehtësi e informacionit zyrtar, në pajtim me ligjet përkatëse në fuqi.

Neni 8

Takimet e Mekanizmit Koordinues Lokal

1. Takimet e rregullta të Mekanizmit Koordinues Lokal mbahen çdo tre (3) muaj.

2. Varësisht nga rasti, takimet mund të thirren edhe *ad hoc* me propozimin e së paku tre (3) anëtarëve të Mekanizmit Koordinues Lokal.

3.Takimet mbahen në objektet e Komunës ose përjashtimisht në ndonjë hapësirë tjetër të përshtatshme për anëtarët e Mekanizmit Koordinues Lokal.

4. Sekretaria ndihmon në:

4.1. caktimin e datës, kohës dhe vendit të mbledhjes së radhës;

4.2. përgatit rendin e ditës dhe dërgon tek anëtarët e tjerë të Mekanizmit Koordinues Lokal me email për kontributin e tyre, plotësimin e rendit të ditës dhe dërgon versionin përfundimtar të rendit të ditës tek të gjithë anëtarët e Mekanizmit Koordinues Lokal së paku një (1) javë para mbledhjes vijuese, duke i ftuar anëtarët të shtojnë pika të mundshme të rendit të ditës;

4.3.përgatit dhe shpërndan dokumentet përkatëse, kontributet dhe rezultatet, së paku një (1) javë para mbledhjes;

4.4.cakton personin që mban procesverbalin e mbledhjes;

4.5.siguron shërbimet e përkthimit/interpretimit sipas nevojës;

4.6. në rast se anëtar i rregullt i Mekanizmit Koordinues Lokal mungon tre (3) herë radhazi në takime pa arsye, me kërkesën e Kryetarit mund të kërkohej zëvendësimi i tij.

Neni 9

Trajnimi i anëtarëve të Mekanizmit Koordinues Lokal

1.Të gjithë anëtarët e Mekanizmit Koordinues Lokal janë të detyruar të ndjekin trajnime fillestare dhe të avancuara për zhvillimin e aftësive dhe njohurive themelore profesionale.

2. Me qëllim të avancimit të shkathtësive profesionale, anëtarët e Mekanizmave Koordinues Lokal marrin pjesë në trajnime të vazhdueshme në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3.Trajnimet e ofruara duhet të jenë trajnime bazë, trajnime tematike për format e dhunës, dhe trajnime ndër-sektorale fillestare dhe të vazhdueshme, në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, sipas Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe ligjit përkatës.

Neni 10

Raportimi

1.Kryesuesi i mekanizmit përkatës paraqet raport të punës së paku një (1) herë në vit në Kuvendin Komunal të Komunës përkatëse.

2.Kryesuesi i mekanizmit përkatës paraqet raport të punës çdo gjashtë (6) muaj pranë Koordinatorit Kombëtar për mbrojtjen nga dhuna në familje për zbatimin e planeve komunale të veprimit, në përputhje me Strategjinë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Baza Gjimore dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

28 shkurt 2025